

Intervista rrëfyese e McGill-it për gjendjen e dobët shëndetësore (MINI)

Versioni i përgjithshëm për Sëmundje, Gjendje të dobët shëndetësore ose Simptomë.

Danielle Groleau, Allan Young, & Laurence J. Kirmayer ©2006

Translation and adaption: Blerta Salihaj, MD & Kosovo Health Foundation (KHF)

Pjesa 1. RRËFIMI FILLESTAR I GJENDJES SË DOBËT SHËNDETSORE

1. Kur ka qenë hera e parë që keni përjetuar problemin tuaj shëndetësor apo vështirësitë shëndetësore (PSH)? [*Zëvendësoni "PSH-në" në këtë pyetje dhe në pyetjet vijuese me termet që i përdor i intervistuari*] [*Lejoni që rrëfimi të shkoj sa më gjatë që është e mundur, me vetëm thjeshtë duke pyetur, "Pastaj çka ka ndodhur? Dhe pastaj?"*]
2. Ne do të donim të dinim më shumë rreth përvojës suaj. A mund të na tregoni kur e keni vërejtur se ke përjetuar këtë (PSH)?
3. A mund të na tregoni çfarë ka ndodhur kur ju keni përjetuar këtë (PSH)?
4. A ka ndodhur diçka tjetër? [*Përsëriteni sa herë që nevojitet të nxirrni përvoja dhe ngjarje të afërta*].
5. Nëse keni shkuar tek çfarëdo ndihmuesi ose mjeku popullor, na tregoni rreth vizitës suaj dhe çfarë ndodhi pastaj.
6. Nëse keni shkuar në vizitë tek mjeku, na tregoni rreth vizitës suaj tek mjeku/ gjatë hospitalizimit dhe rreth asaj se çfarë ndodhi pastaj.
- 6.1 A keni bërë ndonjë test ose a jeni trajtuar për (PSH-në) tuaj? [*Rëndësia e kësaj pyetjeje varet nga lloji i problemit shëndetësor*].

Pjesa 2. RRËFIMI PROTOTIPIK

7. A keni pasur ndonjë PSH në të kaluarën, të cilin ju e konsideroni të ngjashëm me këtë të tanishmin?
[*Nëse përgjigja në pyetjen # 7 është Po, atëherë kalo në P.8*]
8. Në çfarë mënyre është problemi juaj shëndetësor i mëparshëm i ngjashëm me ose i ndryshëm nga (PSH) i tanishëm?
9. A ka përjetuar ndokush nga familja juaj ndonjëherë problem të ngjashëm shëndetësor me atë të tuajin?
[*Nëse përgjigja në pyetjen #9 është Po, atëherë kalo në P.10*]
10. Në çfarë mënyre e konsideron (PSH-në) tuaj të ngjashëm me ose të ndryshëm nga problemi shëndetësor i këtij personi tjetër?
11. A ka ndonjë person në rrethin tuaj shoqëror (në punë ose shokë tuaj) që ka përjetuar një problem shëndetësor të ngjashëm me të tuajin?
[*Nëse përgjigja në pyetjen #11 është Po, atëherë kalo në p.12*]
12. Në çfarë mënyre e konsideron PSH-në tuaj të jetë i ngjashëm me ose i ndryshëm nga problemi shëndetsor i këtij personi tjetër?
13. A keni parë, lexuar ose dëgjuar në televizor, radio, në revistë, libër ose në Internet për ndonjë njeri i cili ka ankuar nga i njëjti problem si ai i juaji?
[*Nëse përgjigja në pyetjen #13 është Po, atëherë kalo në P.14*]

14. Në çfarë mënyre është problemi i atij personi i ngjashëm me ose i ndryshëm nga ai i juaji?

Pjesa 3. RRËFIMI I MODELIT SPJEGUES

15. A keni ndonjë term ose shprehje tjetër e cila shpjegon (PSH-në) tuaj?
16. Sipas jush, çfarë e ka shkaktuar PSH-në tuaj? [Shkruani shkaqet primare.]
16.1 A ka shkaqe tjera të cilat ju mendoni që kanë pasur ndikim në problemin tuaj?
[Shkruani shkaqet sekondare.]
17. Përse ka filluar PSH i juaj?
18. Çfarë ka ndodhur brenda trupit tuaj e cila mund të sqarojë PSH-në tuaj?
19. A është duke ndodhur diçka në familjen tuaj, në punë ose në jetën tuaj sociale e cila do të mund të shpjegonte problemin tuaj shëndetësor? [Nëse përgjigjja në pyetjen 19 është Po, atëherë kalo në P.20].
20. A mund të na tregoni se si e shpjegon kjo problemin tuaj shëndetësor?
21. A e keni menduar se ju mund të keni [FUTNI SIMPTOM POPULLOR OSE EMËRTIM TË GJENDJES SË DOBËT SHËNDETSORE]
22. Çfarë kuptimi ka [EMËRTIMI POPULLOR] për ju?
23. Çfarë ndodhë zakonisht tek njerëzit të cilët kanë [EMËRTIMIN POPULLOR]?
24. Cili është trajtimi më i mirë për njerëzit të cilët kanë [EMËRTIMIN POPULLOR]?
25. Si reagojnë njerëzit tjerë ndaj dikujt që ka [EMËRTIMI POPULLOR]?
26. A njihni dikë që ka pasë [EMËRTIMI POPULLOR]?
27. Në çfarë mënyre është (PSH) i juaj i ngjashëm me ose i ndryshëm nga problemi shëndetësor i atij personit tjetër?
28. A është (PSH) i juaj disi i lidhur ose i ndërlidhur me ngjarje specifike të cilat kanë ndodhur në jetën tuaj?
29. A mund të na tregoni më shumë për ato ngjarje dhe si ato janë të lidhura me PSH-në tuaj?

Pjesa 4. SHËRBIMET DHE PËRGJIGJIA NDAJ TRAJTIMIT

30. Gjatë vizitës suaj tek mjeku (mjeku popullor/shëruesi) për PSH-në tuaj, çfarë problemi ju ka thënë mjeku (shëruesi/mjeku popullor) se keni?
31. A ju ka dhënë mjeku (shëruesi/mjeku popullor) ndonjë trajtim, barna ose rekomandime të cilat ju është dashur t'i ndiqni? [Cekni të gjitha]
32. Si po ballafaqoheni me secilën nga këto rekomandime? [Nëse nevojitet, përsëritni pyetjet nga P.33 në P.36 për secilin rekomandim, barna ose trajtim që është cekur]
33. A jeni në gjendje ta ndiqni atë trajtim (ose rekomandim ose terapi)?
34. Çfarë ka bërë që ky trajtim të ketë efekt?
35. Çfarë ka bërë që ky trajtim të jetë i vështirë për tu ndjekur ose të ketë sukses të dobët?
36. Çfarë trajtime keni pritur të keni rreth PSH-së tuaj të cilat ju nuk i keni pasur?
37. Çfarë terapie, trajtim, ndihme ose përkujdesje tjetër keni kërkuar?
38. Çfarë terapie, trajtim, ndihme ose përkujdesje tjetër do të dëshironit të keni?

Pjesa 5. NDIKIMI NË JETË

39. Si e ka ndryshuar PSH i juaj mënyrën tuaj të të jetuarit?
40. Si e ka ndryshuar PSH i juaj mënyrën se si ndjeheni ose mendoni rreth vetvetes suaj?
41. Si e ka ndryshuar PSH i juaj mënyrën se si shikoni jetën në përgjithësi?
42. Si e ka ndryshuar PSH i juaj mënyrën se si të tjerët ju shikojnë juve?
43. Çfarë ju ka ndihmuar gjatë gjithë kësaj periudhe të jetës suaj?

44. Si ju kanë ndihmuar familjarët dhe shokët gjatë kësaj periudhe të vështirë të jetës suaj?
45. Si ju ka ndihmuar jeta juaj shpirtërore, besimi dhe praktikat fetare të kaloni nëpër këtë periudhë të vështirë të jetës suaj?
46. A ka ndonjë gjë që do të dëshironit të shtoni?